



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

I.AGJ.nr.1/2024-21

Me datë 05.04.2024

KËSHILLIT GJYQËSOR TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

RAPORTI PËR PUNËN E GJYKATËS THEMELORE DHE DEGËVE TË SAJ NË DRAGASH DHE SUHAREKË PËR TRE MUJORIN E PARË (JANAR – SHKURT – MARS) 2024

Në kuptim të nenit 14 paragrafi 2 nën paragrafi 2.5 të Ligjit për Gjykatat, paraqes raportin për tre mujorin e parë I-rë (Janar – Shkurt – Mars 2024).

Fillimi i vitit 2024 për punën e gjykatës e karakterizon një fillim të punës së suksesshme të përfundimit të vitit 2023. Respektivisht duke u bazuar në faktin se në tremujorin e fundit të vitit 2023 jemi barazuar me lëndë në sistemin SMIL dhe lëndët fizike të cilat janë në punë në gjykatë është një nismë e mirë pozitive dhe një bazë e qëndrueshme për punën e vitit 2024.

Tashmë Gjykata Themelore në Prizren pas një riorganizimi, ka një ritëm të punës që qon në trendë pozitive sa i përket rezultatit dhe efikasiteti dhe organizimit dhe shpërndarjes së punës.

Në tre mujorin e I-rë, që në fillim në muajin janar kemi pasur takime me gjyqtarët e divizioneve të caktuar veç e veç dhe së bashku me kolegjiun e rregullt të mbajtur me dt. 29.03.2024. Respektivisht me dt. 16.01.2024 është mbajtur takimi me gjyqtarët e Departamentit për Krime të Rënda dhe Departamentit për të Mitur ku rendi i ditës ka qenë – Raporti i punës i vitit 2023 sa i përket këtij departamenti dhe janë analizuar statistikat, është shqyrtuar plani i punës për vitin 2024 dhe ka pasur edhe pika të ndryshme të cilat janë diskutuar me gjyqtarë, njëra nga këto pika ka qenë formimi i trupave gjyquese në vitin 2025 sipas ndryshimit të KPPRK-së dhe pengesat të cilat duhet të evitohen pasi që në këtë departament janë vetëm 4 gjyqtarë dhe në ndërkohë një gjyqtare do të pensionohet dhe kjo duhet të evitohet dhe të caktohet një gjyqtar nga Departamenti i Përgjithshëm për plotësim të numrit të anëtarëve sipas KPPRK-së.

Me dt.17.01.2024 është mbajtur Kolegjiun me gjyqtarë të Departamentit të Përgjithshëm – Divizioni Penal dhe Divizionit të Kundërvajtjes ku si rendi i ditës ka qenë raporti i punës për vitin 2023 dhe analizat statistikore për këtë departament dhe divizion dhe plani i punës për vitin 2024, gjithashtu janë diskutuar edhe tema të ndryshme konkrete që kanë të bëjnë me punën e gjyqtarëve.

Me dt.18.01.2024 është mbajtur kolegjiun me gjyqtarët e Departamentit të Përgjithshëm Divizioni Civil me rend të ditës raporti i punës dhe statistikat për vitin 2023 dhe organizimi i punës sipas planit të punës për vitin 2024. Janë diskutuar shumë tema të ndryshme nga ana e gjyqtarëve që kanë të bëjnë me probleme konkrete në punën e tyre dhe është hartuar plani konkret për zgjidhjen e këtyre problemeve.

Me dt.19.01.2024 pasi që janë mbajtur takimet e ndara me secilin departament dhe divizion është mbajtur kolegji i përbashkët në lidhje me aprovimin e Planit të Punës për vitin 2024 ku është votuar dhe aprovuar ky plan.

Më pas bazuar në Planin e punës për vitin 2024 dhe duke pasur parasysh se në vitin 2023 kemi pasur ngecje në realizimin e planit nga ana e zyrës së përmbartimit dhe zyrës së ekzekutimeve penale është mbajtur takimi me gjyqtarin përmbartues dhe zyrtarët të cilët punojnë në këto zyre, takimi është mbajtur me dt.06.02.2024 ku është biseduar për planin dhe strategjinë e zvogëlimit të lëndëve të vjetra, për organizim më të mirë të zyre dhe për hapat konkrete të punës për secilin zyrtar. Gjithashtu si Kryetare e gjykatës dhe në kuadër të obligimeve të punës që i kam në lidhje me ekzekutimin e dënimeve penale kam bërë vizitë në këtë zyre, jam njoftuar me numrin e lëndëve në tërësi, planin e punës, për numrin e lëndëve të cilat kryhen për çdo muaj si dhe organizimin e tërësishëm të punës në sistemin SMIL në këtë zyre.

Me dt. 04.03.2024 kemi mbajtur takim me bashkëpunëtorët të caktuar në lëminë civile ku është analizuar puna dhe rezultatet e punës së tyre dhe janë caktuar bashkëpunëtorët të cilët do të punojnë me gjyqtarët. Kjo është bërë me short ku secili gjyqtar e ka tërheq shortin dhe me këtë ka zgjedhur bashkëpunëtorin i cili do të punojë me te. Sipas planit tani secili gjyqtar ka një bashkëpunëtor. Bashkëpunëtorët janë udhëzuar që të bashkëpunojnë me gjyqtarët dhe që në fillim të bëjnë shqyrtimin paraprak të padisë menjëherë pas pranimit të lëndës si dhe të punojnë me lëndët tjera sipas planit të punës së gjyqtarit.

Me dt.03.04.2024 kemi mbajtur takim me bashkëpunëtorët të caktuar në lëmi penale ku është analizuar puna dhe rezultatet e punës së tyre. Gjithashtu, janë përcaktuar detyrat e punës për tremujorin e parë të vitit 2024.

Me dt. 26.02.2024 kemi mbajtur një takim me gjyqtarët e Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Suharekë ku është diskutuar për punën e gjykatës në tërësi si dhe për problemet konkrete që kanë të bëjnë me numrin e lëndëve të ngarkuar tek secili gjyqtar, numrin e lëndëve me padi që rrjedhin nga Kontrata Kolektive, problemet rreth publikimeve të vendimeve, lëndët e vjetra të Divizionit të Kundërvajtjes, lëndët përmbartimore, ndërmjetësimi, mungesa e stafit administrativ.

Pas përfundimit të këtyre takimeve është mbajtur Kolegji i rregullt me të gjithë gjyqtar me dt. 29.03.2024 ku rendi i ditës ka qenë raporti statistikor i punës së gjykatës për këtë tremujor, raporti statistikor për lëndët e kryera për secilin gjyqtar, zbatimin e Planit Strategjik të KGJK-së dhe Planit të Punës për gjykatë për vitin 2024 si dhe shumë tema të ndryshme.

Ndër të tjera, si Kryetare e gjykatës në ditë të caktuara organizojmë "ditën e hapur" ku presim në takim qytetarët dhe palët e interesuara, shqetësimet dhe kërkesat e të cilëve i adresojmë dhe i trajtojmë me gjyqtarët dhe stafin mbështetës. Një takim i hapur publik është mbajtur me qytetarë në organizim të Shoqatës CLARD me dt.18.03.2024, kurse takimi i rregullt me qytetarët mbahet në fund të çdo muaji.

Perfomanca e Gjykatës – Departamenteve dhe Divizioneve e shprehur në normë efikasiteti në %.

Në tremujorin e I-rë të vitit 2024, në tërësi si gjykatë kemi rezultate stabile dhe në vazhdimësi gjykata ka një performancë të mirë efikasitetit, në bazë të përqindjeve në lëndët e pranuar dhe atyre të zgjidhura.

E shprehur dha paraqitur në % norma e efikasiteti është si në vijim:

Gjykata Themelore Prizren

D. Krime të Rënda — Norma e zgjidhjes së lëndëve 129% (40 lëndë të zgjidhura)
(134 aktive/në punë)

D. Mitur - Norma e zgjidhjes së lëndëve 100% (20 lëndë të zgjidhura).
(44 aktive/në punë)

D. i Përgjithshëm – Divizioni Penal – Norma e zgjidhjes së lëndëve 99% (380 lëndë të zgjidhura).
(2,303 aktive/në punë)

Divizioni Civil – Norma e përgjithshme e zgjidhjes së lëndëve 87 %

Kontestimore – Norma e zgjidhjes së lëndëve 66% (1,649 Lëndë të zgjidhura)

Jo Kontestimore – Norma e zgjidhjes së lëndëve 108% (235 lëndë të zgjidhura)

Përmbartimore – Norma e zgjidhjes së lëndëve 180% (338 Lëndë të zgjidhura)

Kundërvajtje – Norma e zgjidhjes së lëndëve 129% (589 Lëndë të zgjidhura).

Aktive/Në punë

Kontestimore – 9.554 lëndë

Jo Kontestimore – 671 lëndë

Përmbartimore – 1,549 lëndë

Kundërvajtje – 1,901

Totali: 13,676 lëndë

Sipas raportit të përgjithshëm të gjykatës, figurojnë 1,701 lëndë përmbartimore në pritje. Ndërsa gjyqtarit Sami Gashi sipas raportit për gjyqtar, nuk i figuron ky numër i lëndëve.

Kjo mos përputhje në SMIL, figuron negativisht në të dhënat e përgjithshme për lëndët në pritje për gjykatën. Për këtë problem dhe mospërputhje kemi angazhuar zyrtaren e SMIL-it që është duke punuar që kjo mosbarazim të evitohet dhe të kemi statistika reale edhe për këtë zyre.

Në Departamentin për Krime të Rënda, ka një rënie në efikasitet e shprehur në %, ka rritje të zgjidhjes së rasteve në Departamentin për të Mitur dhe Divizionin Penal.

Ndërsa në Divizionin Civil ka një rritje të efikasitetit të zgjidhjes së lëndëve, sidomos lëndët përmbartimore ku qytetarët presin drejtpërdrejt realizimin e një të drejte, pasi që numri i lëndëve aktive ka rënë ndjeshëm.

Kjo është rezultat i angazhimit të të gjithë gjyqtarëve në këtë divizion dhe rritjes së numri të bashkëpunëtorëve, dhe ndarjes së punëve në mënyrë të barabartë edhe të bashkëpunëtorëve profesional që angazhohen me gjyqtarët.

Për më tepër bashkëngjitur keni tabelat e ndara në mënyrë specifike trajtimin e lëndëve sipas natyrës.

Gjykata Themelore Prizren - Degë në Suharekë

Aktualisht në këtë gjykatë janë 6 gjyqtarë, katër (4) në lëmine civile dhe dy (2) në lëmine penale, kurse për lëndët e divizionit të kundërvajtjes që nga Janari i 2023 këto lëndë i trajtojnë gjyqtarët e Divizionit Penal.

Angazhimi i dy (2) gjyqtarëve në Divizionin Civil, ka rezultuar menjëherë me rritje të efikasitetit në zgjidhjen e lëndëve, dhe besojmë që në vazhdimësi gjatë vitit 2024, do të ketë rënie të numrit të lëndëve aktive, sidomos në Divizionin Civil.

Efikasiteti i shprehur në %

Divizioni Civil – Norma e përgjithshme e zgjidhjes së lëndëve 112%
Kontestimore – Norma e zgjidhjes së lëndëve 127% (476 Lëndë të zgjidhura)
Jo Kontestimore – Norma e zgjidhjes së lëndëve 72% (42 lëndë të zgjidhura)
Përmbarimore – Norma e zgjidhjes së lëndëve 72% (129 Lëndë të zgjidhura)
Kundërvajtje – Norma e zgjidhjes së lëndëve 118% (259 Lëndë të zgjidhura).

Aktive / Në punë

Kontestimore – 2,794 lëndë
Jo Kontestimore – 107 lëndë
Përmbarimore – 1,426 lëndë
Kundërvajtje – 808

Totali: 5,315 lëndë

D. i Përgjithshëm – Divizioni Penal – Norma e zgjidhjes së lëndëve 110% (114 lëndë të zgjidhura) (493 aktive/në punë)

Në tremujorin e I-rë, kjo gjykatë ka treguar rritje të efikasitetit dhe hapa shumë pozitiv në Divizionin Civil dhe ka rënie të numrit të lëndëve aktive, për rreth 600 lëndë.

Mirëpo me rritjen e numrit të gjyqtarëve në 6, nevojitet që të kihet parasysh edhe angazhimi i bashkëpunëtorëve profesional, sepse ka rënë në tre (3). Ashtu që të synohet që deri në qershor të vitit 2024, të ketë një punë efikase dhe nga 1,500 lëndë për gjyqtarë ky numër të bie rreth 900 lëndë për gjyqtarë.

Duke marrë parasysh numrin e gjyqtarëve ku gjatë vitit 2022 janë pensionuar tre (3) gjyqtarë dhe stafin administrativ, kjo Gjykatë tregon një efikasitet të lartë dhe një organizim të mirë të punës dhe ndarjes së barabartë të punës dhe lëndëve, mirëpo në normë efikasiteti në formë statistikore nuk shfaqet gjendja reale kjo për shkak të numrit të madh të lëndëve në ardhje,

përkundër faktit që është Degë e gjykatës mbulon një territor dhe komunë me numër të lartë të banorëve.

Gjyqtari mbikëqyrës i kësaj gjykate Selajdin Gallapeni pret në takim palët dhe personat e interesuar, ku ankesat dhe kërkesat e të cilëve i adreson te gjyqtarët.

Gjykata Themelore – Dega në Suharekë përballet me mungesë të stafit administrativ, referentë, roje sigurimi dorëzues, dhe pozita të tjera të cilat shfaqin pengesa në arritjen e synimeve dhe përmbushjen e të gjitha detyrave me kohë.

Gjykata Themelore Prizren - Dega në Dragash

Në këtë gjykatë funksionojnë gjyqtari mbikëqyrës i cili njëkohësisht punon edhe në Gjykatën Themelore në Prizren, kurse në degën në Dragash është i angazhuar në divizionin penal si dhe një gjyqtare e cila është e angazhuar në të gjitha lëmitë.

Efikasiteti i shprehur në %

Divizioni Civil – Norma e përgjithshme e zgjidhjes së lëndëve **37%**

Kontestimore – Norma e zgjidhjes së lëndëve **26% (49 Lëndë të zgjidhura)**

Jo Kontestimore – Norma e zgjidhjes së lëndëve **86% (80 lëndë të zgjidhura)**

Përmbarimore – Norma e zgjidhjes së lëndëve **67% (10 Lëndë të zgjidhura)**

Kundërvajtje – Norma e zgjidhjes së lëndëve **178% (16 Lëndë të zgjidhura).**

Aktive / Në punë

Kontestimore – 1,395 lëndë

Jo Kontestimore – 80 lëndë

Përmbarimore - 283 lëndë

Kundërvajtje – 78

Totali: 1,836 lëndë

D. i Përgjithshëm – Divizioni Penal – Norma e zgjidhjes së lëndëve **69% (18 lëndë të zgjidhura)**
(316 aktive/në punë)

Në këtë gjykatë ka rënie të numrit të lëndëve aktive në lëmine Përmbarimore dhe në Divizion për Kundërvajtje.

Raporti për moshën e lëndëve në pritje

Raportimi për këtë natyrë të lëndëve bëhet duke u bazuar në Planet strategjike për trajtimin e lëndëve më të vjetra se 24 muaj.

Në bazë të të dhënave të përpunuara nga SMIL, për moshën e numrit të lëndëve në pritje, pritje në Gjykatën Themelore në Prizren dhe degët Suharekë & Dragash, është si në vijim:

Gjykata Themelore Prizren

Departamenti për Krime të Rënda – Nga 134 lëndë në pritje, janë 35 lëndë më të vjetra se dy vite apo 26%.

Departamenti për të Mitur – Nga 44 lëndë në pritje, janë 15 lëndë më të vjetra se dy vite apo 34%.

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal – Nga 2,303 janë 727 lëndë më të vjetra se dy vite muaj apo 35%.

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil – Nga 9,554 lëndë Kontestimore, më të vjetra se 24 muaj janë gjithsej 2,551 lëndë apo 26%.

Jo Kontestimore – nga 671 lëndë në pritje, janë 434 lëndë më të vjetra se dy vite apo 64%.

Përmbartimore, nga 1,549 lëndë në pritje, janë 346 lëndë më të vjetra se dy vite apo 35%.

Gjykata Themelore Prizren – Dega në Suharekë

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal – Nga 493 në pritje, janë 169 lëndë më të vjetra se 24 muaj, apo 33%.

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

Kontestimore nga 2,974 lëndë në punë dhe aktive, më të vjetra se 24 muaj janë gjithsej 1,035 lëndë apo 34%.

Jo Kontestimore nga 107 lëndë në pritje, janë 30 lëndë më të vjetra se dy vite.

Përmbartimore nga 1,426 lëndë në pritje, janë 313 lëndë më të vjetra se dy vite

Gjykata Themelore Prizren – Dega në Dragash

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal – Nga 316 lëndë në pritje, janë 88 lëndë më të vjetra se 24 muaj apo 27%.

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil – Nga 1,395 lëndë kontestimore në punë dhe aktive, më të vjetra se 24 muaj janë gjithsej 357 lëndë, apo 26%.

Jo Kontestimore – nga 80 lëndë në pritje, janë 37 lëndë më të vjetra se dy vite.

Përmbartimore, nga 283 lëndë në pritje, janë 50 lëndë më të vjetra se dy vite.

Raporti për anulimin/dështimin e seancave gjyqësore

Gjykata Themelore Prizren

Sa i përket shtyrjes së seancave në bazë të të dhënave të siguruar nga sistemi SMIL në Departamentin për Krime të Rënda, në tremujorin e I-rë, 2024, janë shtyrë/anuluar 12 seanca gjyqësore.

Në Departamentin për të Mitur, në tremujorin e I-rë, 2024, janë shtyrë/anuluar 3 seanca gjyqësore.

Në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Penal, në tremujorin e I-rë, 2024, janë shtyrë/anuluar 118 seanca gjyqësore, 64 mungesa e të pandehurit, 9 mos paraqitja e dëshmitarit, 20 shtyer sipas detyrës zyrtare.

Në Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Civil, në tremujorin e I-rë, 2024, janë shtyrë/anuluar gjithsej, 22 seanca, 8 për shkak të mos ftesës së rregullt të palëve në procedurë, 11 sipas kërkesës së palëve.

Gjykata Themelore Prizren – Dega në Suharekë

Në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Penal, në tremujorin e I-rë, 2024, janë shtyrë/anuluar 50 seanca gjyqësore, 31 mungesa e të pandehurit, 7 mos paraqitja e avokatit, dhe për arsye të tjera.

Në Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Civil, në tremujorin e I-rë, 2024, janë shtyrë/anuluar gjithsej, 13 seanca.

Gjykata Themelore Prizren – Dega në Dragash

Në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Penal, në tremujorin e I-rë, 2024, janë shtyrë/anuluar 21 seanca gjyqësore, 8 mungesa e të pandehurit, 7 mos paraqitja e dëshmitarit dhe për arsye të tjera.

Në Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Civil, në tremujorin e I-rë, 2024, janë shtyrë/anuluar gjithsej 30 seanca.

Këto statistika janë marrë nga Sistemi SMIL i cili i përpunon të gjitha shënimet të cilat gjyqtarët dhe zyrtaret që punojnë me gjyqtarë i evidentojnë në këtë sistem.

Për më tepër bashkëngjitur gjeni raporte në tabela të veçanta.

Raporti për publikim të vendimeve

Publikimi i vendimeve gjyqësore tashmë një detyre dhe obligimi ligjor, të cilin Gjykata Themelore në Prizren e përmbush në harmoni me Udhëzimet Administrative.

Gjatë periudhës Janar – Shkurt - Mars, janë publikuar 1,391 vendime gjyqësore.

Gjykata Themelore Prizren – 1,355 vendime.

Gjykata Themelore Prizren – Dega në Dragash 12 vendime.

Gjykata Themelore Prizren – Dega në Suharekë 24 vendime.

Mesatarisht Gjykata Themelore në Prizren publikon ndërmjet 350-450 vendime në muaj, varësisht nga efikasiteti i zgjidhjes së lëndëve.

Lidhur me këtë, ne kemi shikuar dhe vlerësuar raportin e Lëvizjes FOL dhe ashtu sikurse në të kaluarën do të marrim parasysh komentet dhe vlerësimet e tyre.

Përpos vendimeve për rastet që trajtohen, gjykata vazhdon të publikoj brenda afatit ligjor edhe vendimet për rastet disiplinore që trajtohen nga Autoriteti Kompetent.

Marrë në përgjithësi, në bazë të të dhënave nga numri i lëndëve të zgjidhura, përjashtimisht vendimet që nuk publikohen sipas udhëzimeve administrative, Gjykata Themelore në Prizren publikon të gjitha vendimet tjera që janë për tu publikuar, nga të gjitha Departamentet dhe Divizionet, duke respektuar 100% udhëzimet Administrative për publikimin e vendimeve Gjyqësore, pasi që kujdesemi që të mos publikojmë vetëm si numër por të kemi kujdes edhe në cilësinë e mënyrë së publikimit të vendimeve.

Angazhimi i Bashkëpunëtorëve Profesional

Sa i përket angazhimeve të bashkëpunëtorëve profesional në gjykatën tonë tani janë 22 bashkëpunëtor profesional, 10 prej tyre janë angazhuar në Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Civil, kurse 12 të tjerë në Departamentin për Krime të Rënda dhe Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Penal dhe Divizioni i Kundërvajtjes. Të gjithë bashkëpunëtorët në përfundim të çdo tremujori i dorëzojnë raportin e punës për tre muaj i cili analizohet nga ana e Kryetares.

Në këtë drejtim edhe bashkëpunëtorët është mbajtur një kolegjum me dt. 12.01.2024 ku është diskutuar performanca e punës së bashkëpunëtorëve për vitin 2023, plani i punës për vitin 2024 dhe tema të tjera. Bashkëpunëtorët që punojnë në divizionin civil janë caktuar një bashkëpunëtor një gjyqtar, kurse në divizionin penal duke pasur parasysh se nuk ka numër të mjaftueshëm të bashkëpunëtorëve janë caktuar sipas kërkesës dhe ngarkesës së gjyqtarit një bashkëpunëtor me dy gjyqtarë. Një bashkëpunëtor është e nacionalitetit boshnjak dhe e njëjta punon me dy gjyqtare që janë të nacionalitetit boshnjak. Bashkëpunëtorët të cilët janë të caktuar në lëmi penale përveç punës me gjyqtarë punojnë edhe punët tjera si ndërmjetësim, në vendosje për kërkesa për shlyerje të dënimeve, në ekzekutime, në asgjësime dhe punë tjera të perkohshme të cilat paraqiten në raste kur duhet të punohet me emergjencë. Të gjithë bashkëpunëtorët në raste të caktuara kur mungojnë zyrtaret ligjore i zëvendësojnë të njëjtat nëpër gjykime.

Referimi i rasteve gjyqësore në ndërmjetësim

Referuar rasteve të ndërmjetësimit në tremujorin e I-rë, janë si në vijim:

Janar - Janë referuar 31 raste për ndërmjetësim (7 Civile – 24 penale)

Janë kryer 27 raste me ndërmjetësim, 4 janë kthyer tek gjyqtari.

Shkurt - Janë referuar 36 raste për ndërmjetësim (14 Civile – 22 penale)

Janë kryer 32 raste me ndërmjetësim, 4 janë kthyer tek gjyqtari.

Mars - Janë referuar 38 raste për ndërmjetësim (19 Civile – 19 penale)

Janë kryer 30 raste me ndërmjetësim, 5 janë kthyer tek gjyqtari, në 3 raste janë tërhequr nga padia.

Në tremujorin e I-rë, me dt.14.02.2024 kemi pasur një takim dhe bashkëbisedim me partnerët e USAID dhe gjyqtarët e Divizionit Civil, për referimin e rasteve në ndërmjetësim, ku janë diskutuar sfidat për ndërmjetësim dhe janë paraqitur kërkesa konkrete nga ana e gjyqtarëve, të cilat do të ndihmonin në promovimin e ndërmjetësimit.

Gjykata Themelore në Prizren ka të caktuar një bashkëpunëtoresh profesionale si referente për ndërmjetësim, dhe një praktikant/e, që ndihmon për trajtimin e rasteve të referuar në ndërmjetësim.

Në gjykatë ka një zyre të veçantë për trajtimin e rasteve për ndërmjetësim.

Gjithashtu jemi duke planifikuar, por që ende nuk është vendosur që edhe në Gjykatën Themelore Prizren – Dega në Suharekë të krijojmë një hapësirë të veçantë dhe të caktojmë një zyrtar për trajtimin e rasteve për ndërmjetësim.

Ekzekutimi i dënimeve në procedurën civile dhe penale;

Kryetarja e gjykatës ka nën mbikëqyrje të drejtpërdrejtë ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale dhe efikasiteti i këtyre zyrave është mbi 100%. Zyra për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe ekzekutimet civile, në vazhdimësi paraqesin raporte tre mujore për punën dhe aktivitete tek Kryetarja e gjykatës dhe këto raporte bashkëngjiten në raporte tre mujore të rregullta që raportohen në KGJK të cilat janë miratuara në mbledhjet e KGJK-së.

Gjykata Themelore Prizren

Dënime me Burgim

Zyra për ekzekutimin e sanksioneve penale gjatë tremujorit të I-rë të vitit 2024, ka ekzekutuar 13 lëndë të dënimeve me burgim, është parashkruar 1 lëndë.

Dënime me Gjobë

Gjatë tremujorit të I-rë, janë ekzekutuar 164 dënime me gjobë, në 16 lëndë dënimi me gjobë është ekzekutuar me burgim.

Ekzekutime Civile

Zyra për ekzekutimin e sanksioneve civile gjatë tremujorit të I-rë, janë pranuar 168 lëndë dhe janë kryer gjithsej 251 lëndë. Në këtë zyre janë të angazhuar tre (3) zyrtar.

Ekzekutime të kundërvajtjes

Gjatë tremujorit të I-rë të vitit 2024 në Gjykatën Themelore në Prizren, janë ekzekutuar 132 lëndë të kundërvajtjes, janë parashkruar 109 lëndë dhe në fund të periudhës raportuese kanë mbetur aktive 1020 lëndë.

Gjykata Themelore Prizren – Dega në Suharekë

Zyra për ekzekutimin e sanksioneve penale në Suharekë gjatë tremujorit të I-rë të vitit 2024, ka ekzekutuar 16 lëndë me burgim, 46 lëndë të ekzekutimeve të dënimeve me gjobë dhe 79 lëndë të kryera – shpenzime të paushallit gjyqësor, ndërsa sa i përket ekzekutimit të lëndëve të kundërvajtjes gjithsej janë kryer 91 lëndë prej tyre 52 të paguara dhe 43 me parashkrim.

Gjykata Themelore Prizren – dega në Dragash

Dënime me burgim

Gjatë tremujorit të I-rë të vitit 2024 në këtë degë të gjykatës kanë qenë në trajtim 3 lëndë të dënimit me burgim, prej të cilëve një 1 është kryer.

Dënime me Gjobë

Gjatë tremujorit të I-rë, janë ekzekutuar 3 dënime me gjobë, ndërsa 67 lëndë janë aktive.

Ekzekutime Civile

Gjatë tremujorit të I-rë të vitit 2024 në degën në Dragash janë zgjidhur 148 lëndë dhe kanë mbetur aktive 479 lëndë.

Trajtimi i rasteve të shënjestruara

Në Gjykatën Themelore në Prizren, është në punë një rast (SHKOLLA), për një pikë të aktakuzës për një të akuzuar (në fillim kanë qenë 3 të akuzuar për disa pika të aktakuzës). Kjo lëndë nga Departamenti për Krime të Rënda, është bartur në Departamentin e Përgjithshëm për shkak të kompetencës sa i përket natyrës së veprës penale për të cilën rasti është kthyer në rivendosje.

Gjithashtu, tashmë është regjistruar në sistemi SMIL dhe i është ndarë në punë gjyqarit një lëndë e kthyer në rigjykim për një pikë të aktakuzës, rasti “KRISTAL”, i cili është trajtuar nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme. Ashtu që, në fillim të vitit 2024, kemi raste aktive të shënjestruara.

Në përfundim duhet të cekim se ky vit do të ketë sfida të ndryshme të cilat duhet ti tejkalojmë (si numri i madh i lëndëve civile, pensionimi i tre gjyqtarëve, të stafit administrativ dhe fillimi i punës me audio incizime nëpër salla të gjykimit etj) por zotohemi se me organizim të mirëfilltë do ti tejkalojmë këto pengesa dhe me ndihmën e KGJK-së do të arrijmë rezultate të mira dhe do të kemi bilan pozitiv.

**Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prizren
Shpresa EMRA**



Gjykata Themelore
PRIZREN

Sipas referencës:

AGJ.nr.	I.AGJ.nr.1/2024-20
Të datës:	03.04.2024

KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

R A P O R T

për punët e kryera

Periudhat raportuese

Të vitit	Kohët e vitit	
2024	Çereku I.	2024
	Çereku II.	
	Çereku III.	
	Çereku IV.	
Tërësisht për vitin		

I. Nga menaxhimi i përgjithshëm:

1.

Është gjykatë themelore e rajonit të		PRIZRENIT				me Komunitat rrethuese								
Kjo gjykatë themelore						Sipas degëve të veta, të cilat								
Funksionon në qytetin e:		Vendos sipas departamenteve:				Funksionojnë në:		Vendosin sipas departamentit nr.5:						
1. Juridiksioni i gjykatës		1. Krime të rënda				Penal	1	SUHAREKË		5. I përgjithshëm sipas divizioneve:				
		2. Për të mitur					Civil	2	DRAGASH					
		3. I përgjithshëm sipas divizioneve:					Kundervajtje	3						
							Egzekutime	4						
Komenti:														

2.

2.1 Numri i gjyqtarëve sipas angazhimit në punë, paraqitur strukturën gjinore dhe përkatësinë nacionale:																	
Gjykata themelore + Degët e gjykatës																	
Aprovuara						0				Plotësuara		37		Lira		-37	
Shqiptar						Turq				Goran		Ashkalinj		Rom		Gjithësej	
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F
22	10	0	0	1	2	1	0	0	0	0	0	0	0	1	0	25	12
32		0		3		0		0		0		1		37			
Gjykata themelore																	
PRIZREN						Aprovuara				Plotësuara		29		Lira		-29	
Shqiptar						Turq				Goran		Ashkalinj		Rom		Gjithësej	
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F
15	9	0	0	1	2	1	0	0	0	0	0	0	0	1	0	18	11
24		0		3		1		0		0		1		29			
Dega gjyqësore në																	
SUHAREKË						Aprovuara				Plotësuara		6		Lira		-6	
Shqiptar						Turq				Goran		Ashkalinj		Rom		Gjithësej	
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F
6	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	6	0
6		0		0		0		0		0		0		6			
Dega gjyqësore në																	
DRAGASH						Aprovuara				Plotësuara		2		Lira		-2	
Shqiptar						Turq				Goran		Ashkalinj		Rom		Gjithësej	
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F
1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	1
2		0		0		0		0		0		0		2			
Dega gjyqësore në																	
Aprovuara						Plotësuara				0		Lira		0			
Shqiptar						Turq				Goran		Ashkalinj		Rom		Gjithësej	
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F
0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
0		0		0		0		0		0		0		0			
Dega gjyqësore në																	
Aprovuara						Plotësuara				0		Lira		0			
Shqiptar						Turq				Goran		Ashkalinj		Rom		Gjithësej	
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F
0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

2. Numri dhe struktura e të punësuarve

0	0	0	0	0	0	0	0	0
---	---	---	---	---	---	---	---	---

2.2 Numri i stafit ndihmës të angazhuar në punë, paraqitur strukturën gjinore dhe përkatësinë nacionale:

Gjykata themelore + Degët e gjykatës														Aprovuara		0		Plotësuara		162		Lira		-162	
Shqiptar		Serb		Boshnjak		Turq		Goran		Ashkalinj		Rom		Gjithësej											
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F										
70	72	0	0	1	4	3	3	2	2	0	0	0	5	76	86										
142		0		5		6		4		0		5		162											
Gjykata themelore														PRIZREN		Aprovuara		Plotësuara		110		Lira		-110	
Shqiptar		Serb		Boshnjak		Turq		Goran		Ashkalinj		Rom		Gjithësej											
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F										
39	55	0	0	1	4	3	3	0	0	0	0	0	5	43	67										
94		0		5		6		0		0		5		110											
Dega gjyqësore në														SUHAREKË		Aprovuara		Plotësuara		30		Lira		-30	
Shqiptar		Serb		Boshnjak		Turq		Goran		Ashkalinj		Rom		Gjithësej											
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F										
14	16	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	14	16										
30		0		0		0		0		0		0		30											
Dega gjyqësore në														DRAGASH		Aprovuara		Plotësuara		22		Lira		-22	
Shqiptar		Serb		Boshnjak		Turq		Goran		Ashkalinj		Rom		Gjithësej											
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F										
17	1	0	0	0	0	0	0	2	2	0	0	0	0	19	3										
18		0		0		0		4		0		0		22											
Dega gjyqësore në														Aprovuara		Plotësuara		0		Lira		0			
Shqiptar		Serb		Boshnjak		Turq		Goran		Ashkalinj		Rom		Gjithësej											
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F										
0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0										
0		0		0		0		0		0		0		0											
Dega gjyqësore në														Aprovuara		Plotësuara		0		Lira		0			
Shqiptar		Serb		Boshnjak		Turq		Goran		Ashkalinj		Rom		Gjithësej											
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F										
0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0										
0		0		0		0		0		0		0		0											
Komenti:																									

2. Numri dhe struktura e të punësuarve

Nga Gjykatat themelore + Degët e gjykatës

1. Shfrytëzimi i pushimeve

Për të punësuarit në Gjykatë	Me pagesë				Pa pagesë		
	Vjetor	Mjekësor	Lehonie	Përdëllimit	Ngritje profesionale	Kujdes familjar	Tjetër
Gjyqtar							
Nëpunës							
Total:	0	0	0	0	0	0	0

Komenti:

2. Procedurat e rekrutimit:

Për të punësuarit në Gjykatë	Te shpallura:			Lloji i kontrates		Rezultati i konkurseve	
	Konkurse te jashtme	Konkurse te brendshme	Nr. i kandidateve konkurues	Karrieres / Jo karrieres	Punes	Pozitiv	Negativ
Gjyqtar							
Nëpunës							
Total:	0	0	0	0	0	0	0

Komenti:

3. Disiplinimi:

Për të punësuarit në Gjykatë	Disiplinimi	Komisioni i brendshem		Shkalla e dyte		Lloji i masës	
	Numri i Disiplinimeve	Disiplinuar	Liruar	Disiplinuar	Liruar	Mase e lehte disiplinore	Mase e rende disiplinore
Gjyqtar							
Nëpunës							
Total:	0	0	0	0	0	0	0

Komenti:

4. Ankesat në përgjithësi:

Për të punësuarit në Gjykatë	Ankimimet			Komisioni i brendshem		Shkalla e dyte	
	Numri i ankesave	Ankese per rekrutim	Ankese tjeter	Miratuar	Refuzuar	Miratuar	Refuzuar
Gjyqtar							
Nëpunës							
Total:	0	0	0	0	0	0	0

2. Gjendja aktuale me aktivite te burimeve njerezore

Komenti:

4.

Nga Gjykatat themelore + Degët e gjykatës

1. Për programin e buxhetuar të gjykatës për vitin 2022, shprehur në Euro valutë:

Periodha:	Destinacioni i parasë:	Të buxhetuara:	Të shpenzuara:	Të pa shpenzuara:
Çereku: I./2023	a. Paga dhe mëditje	100,000.00 €	75,096.29 €	24,903.71 €
	b. Mallra dhe shërbime	12,900.00 €	9,324.33 €	3,575.67 €
	c. Shpenzime komunale			- €
	d. Investime kapitale			
	Në përgjithësi:		112,900.00 €	84,420.62 €

Komenti:

Periodha:	Destinacioni i parasë:	Të buxhetuara:	Të shpenzuara:	Të pa shpenzuara:
Çereku: II./2023	a. Paga dhe mëditje			- €
	b. Mallra dhe shërbime			- €
	c. Shpenzime komunale			
	d. Investime kapitale			
	Në përgjithësi:		- €	- €

Komenti:

Periodha:	Destinacioni i parasë:	Të buxhetuara:	Të shpenzuara:	Të pa shpenzuara:
Çereku: III./2023	a. Paga dhe mëditje			- €
	b. Mallra dhe shërbime			- €
	c. Shpenzime komunale			- €
	d. Investime kapitale			
	Në përgjithësi:		- €	- €

Komenti:

Periodha:	Destinacioni i parasë:	Të buxhetuara:	Të shpenzuara:	Të pa shpenzuara:
Çereku: IV./2023	a. Paga dhe mëditje			- €
	b. Mallra dhe shërbime			- €
	c. Shpenzime komunale			- €
	d. Investime kapitale			- €
	Në përgjithësi:		- €	- €

Komenti:

Nga Gjykatat themelore + Degët e gjykatës

2.1. Të hyrat në buxhetin e Kosovës

4.
Hyrye/daljet
financiare

Nga periudhat:	Të inkasuara në Euro valutë, sipas bazës paguese					Gjithësej
	Taksë	Dënim	Paushall	komp.viktim	Konfiskim	
I./2023	114,614.90 €	211,347.00 €		8,350.00 €		334,311.90 €
II./2023						- €
III./2023						- €
IV./2023						- €
Gjithësej:	114,614.90 €	211,347.00 €	- €	8,350.00 €		334,311.90 €

Komenti:

Nga Gjykatat themelore + Degët e gjykatës

2.2. Për të hyrat në Thesarin (Trezorin) e Kosovës

Nga periudhat:	Të inkasuara në Euro valutë, sipas bazës paguese					Gjithësej
	Garancion për kontest	Depozitim (pignus) gjyqësor	Corpus delicti	Parapagim për shpenzime	Për raste tjera	
I./2023		33,890.20 €				33,890.20 €
II./2023						- €
III./2023						- €
IV./2023						- €
Gjithësej:		33,890.20 €				33,890.20 €

Komenti:

5.

5. Çështje Logjistike

6.

6. Prokurimi Publik	Numri i prokurimit publik	Lloji i kërkesës	Shuma	Realizimi	
				po	jo
			- €	0	0
			- €	0	0
			- €	0	0
			- €	0	0
			- €	0	0
E përgjithshme prej: 01.01.2020-31.12.2020			- €	0	0

7.

1. Numri i projektit

2. Emërtimi i projektit:

7. Projektet e realizuara	3. Partenerët e projektit:	
	4. Vlera e projektit:	
	5. Të involvuarit në projekt:	
	6. Kostoja e projektit:	
	7. Rezultatet e projektit:	
	Komenti:	

8.

8. Identifikimi i pengesave në punët për vendimarrje lidhur me paqartësi ligjore në zbatim	Duhet të identifikojmë pengesat sa i përket plotësimit të vendeve të punës për stafin mbështetës e cila në mënyrë të drejpërdrejtë krijojnë paqartësi dhe ndikojnë në vendimarrje. Respektivisht sa i përket numrit të stafit mbështetës me dorëzues dhe zyrtar të arkivës nuk jemi plotësuar në numër të mjaftueshëm dhe duke pasur parasysh se disa zyrtarë janë pensionuar dhe në përgjithësi vendet e tyre të punës ende nuk janë plotësuar në numër të duhur. Gjithashtu nuk janë plotësuar vendet e punës për një përkthyes për gjuhën turke, pozita e Administratorit dhe një zyrtar për financa. Të gjitha këto mosplotësime të këtyre vendeve të punës paraqesin pengesë në realizimin e detyrave të punës dhe objektivave të përcaktuara. Për paqartësi ligjore në zbatim nuk kemi ndonjë vërejtje të veçantë.
--	--

9.

9. Mbledhjet e mbajtura lidhur me menaxhimin e gjykatës dhe lëndëve gjyqësore	Në fillim të vitit 2024 Kryetarja e gjykatës kanë mbajtur takime të rregullta me gjyqtarë të secilit Departament dhe Divizion në lidhje me Strategjinë e KGJK -së dhe programin e paraparë për tejkalim të pengesave dhe realizim të planit. Gjithashtu së bashku me Administratoren janë mbajtur takimet me zyrtarë të zyrës së administratës penale dhe civil dhe posaçërisht me zyrrët të zyreve përmbarrimore, ekezkutime penale dhe të kundërvajtje ku është përpiluar plani i zbatimit të kryerjes së punëve gjatë këtij tremujori si plan afatshkurtë dhe plani gjashtë mujor si plan afatgjatë. Janë përcaktuar detyrat konkrete për zbatim në lidhje me strategjinë për gjyqtarët dhe janë caktuar afatet konkrete për kryerjen e këtyre detyrave. Gjithashtu është mbajtur mbledhje e veçantë me bashkëpunëtorët profesional për punën e organizimit të mbështetjes së punës së gjyqtarve në tërësi si dhe kryerjes së punëve të tyre në veqanti. Me administratoren e gjykatës kryetarja ka mbajtur mbledhjen me stafin administrativ ku edhe janë kryer disa ndryshime
---	--

10.

10. Identifikimi i pengesave në punë dhe propozimi i masave për tejkalimin e tyre	Pengesat në punë janë paraqitur për shkak të mungesës së stafit mbështetës dhe për shkak të problemeve të cilat kanë rezultuar me mospërputhje të të dhënave në sistemin SMIL me gjendjen reale të evidencës së lëndëve. Gjatë muajit janar për shkak të festave të fundëvitit dhe shfrytëzimeve të pushimeve vjetore të viti 2023 kemi pasur lëvizje të shumta në staf dhe kemi përpiluar plan të veçantë së bashku me administratoren për tejkalim të kësaj situatë. Në këtë drejtim nuk kemi pasur kurrfarë problemi edhe pse kemi pasur numrin e kufizuar të stafit mbështetës. Propozojmë që të plotësohen vendet e kërkuara të stafit mbështetës duke pasur parasysh se kemi ndryshim të gjendjes në avansim të personelit të gjykatës.
---	---

11.

--	--

11. Bashkëpunimi i gjykatës me subjektët jo gjyqësor kombëtar dhe ndërkombëtar.	Gjykata ka bashkëpunim të mirëfilltë me organizatat ndërkombëtare si OSCE dhe USAID , kurse me subjekte jogjyqësore ka bashkëpunim me Komunën e Prizrenit, Strehimoren , mbrojtësit të viktimave , ka gadishmëri që të bashkëpunojë me secilin subjekt jo gjyqësor në suaza profesionale dhe në raste kur nuk ndikon në punën e tërësishme të gjykatës. Bashkëpunim të veçantë gjykata ka me Prokurori dhe Polici . Duhet të cekim se bashkëpunimi është i vazhdueshëm , por se gjatë këtij tremujori për shkak të pushimeve ka qenë me intensitet më të vogël dhe i kufizuar në disa takime.
---	---

12. E rëndësishëse veçantë për paraqitje në KGJK	Si kam cekur edhe më herët me funksionalizimin e objektit të ri janë paraqitur shpenzime të shtuara në mbështetje të punës së gjyqtarëve të cilët janë vendosur në këtë objekt të cilët janë 11 gjyqtarë të lëmisë civile dhe të cilët kanë nevojë për asistim në dalje në teren, në dorëzim të ftesave dhe të shkresave tjera nga ky objekt në objektin e vjetër andaj propozojmë që të shqyrtohet mundësia e angazhimit të një vozitësi (i cili është pensionuar), një recepcionisti, një arkivisti (në mungesë të arkivistit të lartë) dhe një mirëmbajtësi pasi që tani kemi dy objekte të Gjykatës kurse këto vende të punës janë mbështetur vetëm me nga një punëtor. Gjithashtu kemi Kërkesë të vazhdueshme për
--	--

II. Treguesit statistikor për lëndët gjyqësore:

III. Përmbyllja

1 Rekomandime për KGJK	Rekomandimet për KGJK-në janë : Të plotësohen vendet e lira të punës së stafit administrativ; të bëhet gëlqerosja e objektit të vjetër gjykatës ; të përfundojë procedura e asgjësimit të lëndëve të kundërvajtjes ; të ndihmohet në mirëmbajtje të arhivave dhe të modernizohen të njejtat me ndonjë sistem mbështetës të arkivimit dhe në tërësi të bëhet mbështetja e punëve rreth stafit administrativ gjithashtu të sigurohet hapësira për arkivim të lëndëve të kryera pasi që të gjitha hapsirat janë të stërbushura, gjithashtu kemi edhe një sasi të kosiderueshme të arhivës të një notere nga Mamusha të pranuar më herët.
---------------------------	---

2 Përfundim përmbledhës	Fillimisht falenderoj KGJK-në për përkrahjen në finalizimin e objektit të ri të gjykatës dhe plotësimin e vendeve të punës për bashkëpunëtor profesional, për referentë dhe për zyrtarë ligjor. Si përfundim mund të cekim se e gjithë puna e gjykatës duhet të jetë në koordinim me KGJK-në në mënyre që të zbatohet Strategjia e aprovuar si dhe të realizohen objektivat e strategjisë.
----------------------------	--



 Kryetarja e gjykatës
 (nënshkrimi)